29.025

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE**
**PARE TE RRETHIT TIRANE**
**Nr.29023.....vendimit**

Tirane,me..5/2/..2003

## VENDIM
## PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane,sot me date..5/2/....2003,une..Altime Kusha... gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane,studjova kerkesen e Artur Rustemit,per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "F K T" shpk Fier,ne te cilen ai eshte ortak i vetem dhe administrator.

Nga studimi i bere,

### KONSTATOVA

Shoqeria tregtare "F K T"shpk Fier,qe eshte krijuar me akt themelimin e dates 22.01.2003 te ortakut te vetem Artur Rustemi.Selia dhe qendra e saj eshte ne lagjen "28 nentori"te qytetit Fier,me kohezgjatje 10 vjet,me kapital 100000(njeqindmije) leke,prone e ortakut te vetem Artur Rustemi.Administrator eshte caktuar Artur Rustemi.

Objekt i veprimtarise se kesaj shoqerie tregtare eshte:

1. **Veprimtari televizive lokale.**
2. **Veprimtari kinematografike per shfaqje publike filmash dhe distribucion(shperndarje) te tyre.**
3. **Studjo per prodhim videokasetash muzikore e filmash,prodhim disqesh muzikore si dhe tregtim te tyre.**
4. **Studjo fotografike.**

Kerkesa e bere per rregjistrimin si person juridik si dhe dokumentet e paraqitura jane te plota dhe te rregullta,si e tille duhet pranuar,

### PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

### VENDOSA:

Te rregjistroj si person juridik shoqerine tregtare " F K T" SHPKFier,me seli dhe qender ne lagjen "28 nentori"te qytetit Fier,me kapital themeltar 100000 leke,prone e ortakut te vetem Artur Rustemi,me administrator gjithashtu Artur Rustemi.

Objekt i veprimtarise se kesaj shoqerie tregtare eshte:

**1.Veprimtari televizive lokale.**

**2.Veprimtari kinematografike per shfaqje publike filmash dhe distribucion(shperndarje) te tyre.**

**3.Studjo per prodhim videokasetash muzikore e filmash,prodhim disqesh muzikore si dhe tregtim te tyre.**

**4.Studjo fotografike.**

GJYQTARE

Altime Kusha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 29025/1 Vendimit

# VENDIM

## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 13/11/03 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane M Dedi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:
- **Artur Rustemi**, per depozitimin prane regjistrit tregetar te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " **F K T** " sh.p.k. dhe:

## KONSTATOVA

Se me vendimin **Nr.29025** dt.05.02.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare " **F K T** " sh.p.k. me ortak te vetem dhe administrator z. **Artur Rustemi.**
Me vendimin **Nr.1** dt. 20.10.2003 te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " **F K T** " sh.p.k. eshte vendosur **pakesimi** i objektit ne fushen e:
- Veprimtari kinematografike per shfaqje publike filmash dhe distribucion ( shperndarje ) te tyre.
- Studio per prodhim videokasetash muzikore e filmash, prodhim disqesh muzikor si dhe tregetimi i tyre.
- Studio fotografike.

Po keshtu eshte vendosur **shtimi** i objektit ne fushen e:
- Transmetime nepermjet radios lokale.

Keshtu objekti i veprimtarise se Shoqerise mbetet:
**1- Veprimtari televizive.**
**2- Transmetime nepermjet radios lokale.**

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit **Nr.7638,** date 19.11.1992, te Ligjit **Nr.7667** date 28.01.1993:

# VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregetar te Gjykates te vendimit Nr.**1** dt. 20.10.2003 te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " **F K T** " sh.p.k. ku eshte vendosur **pakesimi** i objektit ne fushen e:
- Veprimtari kinematografike per shfaqje publike filmash dhe distribucion ( shperndarje ) te tyre.

- Studio per prodhim videokasetash muzikore e filmash, prodhim disqesh muzikor si dhe tregetimi i tyre.
- Studio fotografike.

**Shtimi** i objektit ne fushen e:

- Transmetime nepermjet radios lokale.

Duke mbetur keshtu objekti i veprimtarise se Shoqerise ne fushen e:

**1- Veprimtari televizive.**

**2- Transmetime nepermjet radios lokale.**

Urdherohet zyra e regjistrit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE

Modeli - regjistrimi

1. L 9025

2(a) "F K T" Sh.p.k

(b) Tiranë L. 28 Nëntori

(c) Veprimtari tregtare lokale, riprodhim kinematografik etj

(ç) 100.000 lekë

3. Administrator Artur [illegible]

Ortak i vetëm Artur [illegible]

4. [illegible] nuk [illegible]

Data 28/1/03.

5. 6/2/2003

Vendimi [illegible]

Nr 3/4 Reg. dat. 5/2/03

[illegible signature]

## AKT THEMELIMI

## PER SHOQERINE TREGTARE "F K T "SHPK FIER

Ne Fier,sot me date 22.01.2003,une **ARTUR HETEM RUSTEMI**,konforme ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",ligjit 8410 date 30.09.1998 "Per radion e televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" beje kete akt themelimi:

Me vullnetin tim te lire themeloj shoqerine tregtare me emertimin "F K T " shpk ,shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,ortak i vetem i se ciles jam une i quajturi Artur Rustemi.

Selia dhe qendra e kesaj shoqerie tregtare eshte ne lagjen "28 nentori"te qytetit Fier.

Kjo shoqeri tregtare krijohet me mjetet financiare prone e ortakut te vetem Artur Rustemi,me kapital themeltar prej 100000(njeqindmije) leke.

Shoqeria tregtare ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nenshtrohet ne aktivitetin e vet legjislacionit perkates shqiptar.

Kohezgjatja e veprimtarise se saj do te jete permbi10 vjet pune.

Objekt i veprimtarise se kesaj shoqerie tregtare eshte:

1. **Veprimtari televizive lokale.**
2. **Veprimtari kinematografike per shfaqje publike filmash dhe distribucion(shperndarje) te tyre.**
3. **Studjo per prodhim vidiokasetash muzikore e filmash,prodhim disqesh muzikore si dhe tregtim te tyre.**
4. **Studjo fotografike.**

Organi me i larte drejtues i shoqerise tregtare eshte ortaku i vetem i saj,i cili eshte Artur Rustemi..

Po ashtu i njejti person ,Artur Rustemi, eshte edhe administrator i kesaj shoqerie tregtare.

Ne kete shoqeri tregtare mund te aderojne ortake te rinj,ne kushtet qe do te percaktohen ne marreveshjen e bere me kete rast,e drejte kjo e ortakut te vetem.

Gjithashtu ortaku i vetem ka te drejten te shtoje apo pakesoje objektin e veprimtarise se shoqerise tregtare.

Fitimi i nxjerre nga aktiviteti i ligjshem i kesaj shoqeri tregtare eshte ne favor te ortakut te vetem Artur Rustemi ne masen 100 perqind.

Nderkohe ortaku i vetem Artur Rustemi mbart mbi vehte rrezikun e humbjes deri ne masen 100 perqind te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

Per detyrimet qe kjo shoqeri tregtare mund te kete ndaj personave te tjere juridike apo fizike,pergjigjet me mjetet e veta financiare e materiale.

Per funksionimin sa me normal te shoqerise tregtare do te hartohet statut i saj,ku do parashikohen hollesisht menyra e administrimit e organizimit te saj.

Shoqeria tregtare e mbyll aktivitetin e saj ne rastet e parashikuara nga ligjislacionin shqiptar per fushat perkatse si dhe ne statutin e saj.

Shoqeria tregtare" F K T "shpk Fier merr personalitet juridik me regjistrimin ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

Nje kopje e ketij akt themelimi dhe nje kopje e statutit te shoqerise tregtare "F K T "shpk Fier ruhen ne Gjykaten e Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

THEMELUESI (ORTAKU I VETEM) I SHOQERISE
TREGTARE " F K T "SHPK FIER
**ARTUR RUSTEMI**

Artur Rustemi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT FIER
Nr. 153....

Fier,me 28 . 01 . 2003

VERTETIM

Ne Fier,sot me date 28 . 01 . 2003 perpara meje noteres u paraqit z.ARTUR RUSTEMI,i biri Hetemit dhe Edijes,i vitlindjes 1958,lindur dhe banues ne lagjen "1 maj" te qytetit Fier,me kombesi e shtetesi shqpotare,me zotesi te plote per te vepruar,njohur me pasaporte personale

Ai deklaroi se kete akt e ka perpiluar vete dhe me vullnet te plote dhe te lire e nenshkruan ne pranine time si notere,gje qe e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

NOTERE
VEZIRE DUSHI

# S T A T U T

## PER SHOQERINE TREGTARE "F K T " SHPK FIER

Une,**ARTUR HETEM RUSTEMI**,mbeshtetur ne ligjin 7638 date 19.11.1993 "Per shoqerite tregtare",ligjin 8410 date 30.09.1998 "Per radion e televizionin public e privat ne Republiken e Shqiperise',ligjin 8096 date 21.03.1996 "Per kinematografine" si dhe ne akt themelimin e dates 22.01.2003 te shoqerise tregtare " F K T " shpk Fier,si themelues dhe ortak i vetem ,hartoj kete statut te saj:

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Kjo shoqeri tregtare eshte me pergjegjesi te kufizuar,me statusin e personit juridik shqiptar.

Neni 2

Emertimi i saj eshte" F K T " shpk,e krijuar me akt themelimin e dates 22.01.2003 te ortakut te vetem Artur Rustemi ,me mjetet e tij financiare.

Neni 3

Qendra dhe selia e kesaj shoqerie tregtare eshte ne lagjen "28 nentori" te qytetit Fier.

### OBJEKTI I VEPRMTARISE

Neni 4

Shoqeria tregtare " F K T " shpk Fier ka per objekt veprimtarie:

1. **Veprimtari televizive lokale.**
2. **Veprimtari kinematografike per shgfaqje publike filmash dhe distribucion(shperndarje) te tyre.**
3. **Studjo per prodhim vidiokasetash muzikore e filmas,prodhim disqesh muzikore si dhe tregtim te tyre.**
4. **Studjo fotografike.**

Neni 5

Objekt i veprimtarise te kesaj shoqerie tregtare shtohet,pakesohet apo ndryshohet vetem me vendim te ortakut te vetem.

### MJETET E SHOQERISE TREGTARE

Neni 6

Shoqeria tregtare "F K T "shpk ,per fillimin e veprimtarise se saj ka nje kapital themeltar prej 100000(njeqindmije) leke, te cilat jane prone e ortakut te vetem Artur Rustemi.

Neni 7

Me mjete te shoqerise tregtare kuptohen edhe ato objekte,sende dhe te holla qe fitohen ne te ardhmen nga ushtrimi i veprimtarise se saj.

Neni 8

Per te garantuar zbatimin e detyrimeve ndaj shtetit dhe personave te tjere juridike apo fizike,si dhe per te shtuar veprimtarine e vet,shoqeria tregtare krijon nje fond rezerve qe kap shifren 1/20 e fitimit te vitit paraardhes financiar.

## ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE TREGTARE

Neni 9

Organi i vetem drejtues,operativ e urdherdhenes i kesaj shoqerie tregtare eshte ortaku i vetem dhe njekohesisht administrator i saj, ARTUR RUSTEMI.

Neni 10

Ortaku i vetem dhe njekohesisht administrator i kesaj shoqerie tregtare,ka keto kompetenca kryesore:

Ndryshon qendren,seline dhe emertimin e kesaj shoqerie tregtare.

Ben ndryshime te çfardoshme ne statutin e saj.

Ne se administrator i shoqerise tregtare vendoset nje person joortak,atehere ai ka te drejte ta emeroj apo shkarkoje ate sipas rastit.

Perfaqeson shoqerine tregtare ne marredhenie me shtetin dhe persona te tjere juridike apo fizike.

Ushtron te gjithe kompetencat e tjera te parashikuara ne legjislacionin perkates shqiptar,ne kete statut,ne akt themelimin e saj apo akte te tjera te mevonshme,duke patur te drejten t'u delegoje edhe personave te tjere kompetenca.

Neni 11

Administratori(ortaku i vetem) kur largohet perkohesisht vendos me shkrim zevendesin e tij,duke percaktuar konkretisht detyrimet e te drejtat qe ai do te mbaje per ate periudhe mungese.

Zevendesi nuk ka te drejte te dale jashte tagrave te dhena nga administratori(ortaku i vetem).

## FITIMI DHE NDARJA E TIJ

Neni 12

Pasi paguhen taksat,tatimet,shpenzimet e tjera te domosdoshme,pagat e punonjesve,ngelet fitimi neto i shoqerise tregtare,i cili eshte ne favor te ortakut te vetem Artur Rustemi.

Neni 13

Nga fitimi i realizuar ndahen stimuj per punonjesit me vendim te ortakut te vetem Artur Rustemi.

Ortaku i vetem mbart mbi vehten e tij rrezikun e humbjes deri ne masen 100 perqind te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

## ORGANIZIMI I PERDITSHEM

Neni 14

Per mirefunksionimin e kesaj shoqerie tregtare ortaku i vetem,ne rolin e administratorit ben ndarjen e puneve,duke e organizuar dhe ne njesi te vogla sipas percaktimit te tij.

Neni 15

Per fushen e veprimtarise televizive ne strukturen organizative te shoqerise tregtare "F K T" shpk Fier,do te krijohen ato organizma qe caktohen ne ligjin 8410 date 30.09.1998 "Per radion e televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" si dhe aktet nenligjore ne zbatim te ketij ligji.

Neni 16

Me vendim te ortakut te vetem kjo shoqeri tregtare mund te çele filiale ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise apo edhe jashte territorit te saj.

## MARREDHENIET E PUNES

Neni 17

Ne kete shoqeri tregtare mund te futen ortake te tjere,te rinj ne kushtet qe percaktohen ne kontraten e bere me kete rast sipas vendimit te ortakut te vetem.

Neni 18

Per punonjesit e tjere te shoqerise tregtare behen kontrate te rregullta pune indiiduake dhe kolektive,sipas parashikimeve te bera ne Kodin e Punes se Republikes se Shqiperise.

Neni 19

Punonjesi i shoqrise tregtare pergjigjet disiplinarisht,materialisht dhe sipas rastit edhe penalisht ne se me veprimet apo mosveprimet e veta te fajshme i shkakton deme shoqerise tregtare.

## KOHEZGATJA DHE MYLLJA E SHOQERISE TREGTARE

Neni 20

Shoqeria tregtare " F K T "shpk Fier eshte krijuar per te ushtruar aktivitetin e vet per nje kohe mbi 10 vjet pune te njepasnjeshme.

Neni 21

Kjo shoqeri tregtare mbyllet sipas parashikimeve te bera nelegjislacionin perkates shqiptar dhe at one statutin e shoqerise.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 21

Shoqeria tregtare " F K T " shpk Fier merr personalitet me regjistrimin ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane.

Neni 22

Nje kopje e ketij statuti si dhe nje kopje e akt themelimit depozitohen me aktet e tjera ne regjistrin tregtar ne Gjykaten e Shkalles se Pare te rrethit Tirane.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGTARE
" F K T" SHPK F I E R

**ARTUR RUSTEMI**

Artur Rustemi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT FIER
Nr...134.....

Fier,me..28.07...2003

VERTETIM

Ne Fier,sot me date..28.07..2003 perpara meje noteres u paraqit shtetasi ARTUR RUSTEMI,i biri Hetemit dhe Edijes,i vitlindjes 1958,banues ne lagjen "1 maj" te qytetit Fier,me kombesi e shtetesi shqiptare,njohur me pasaporte personale

Ai deklaroi se kete akt e ka perpiluar vete dhe nenshkruan me vullnet te lire dhe te plote ne pranine time,une noterja e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

PULLE TAKSE ... LEKE ... E SHQIPERISE

NOTERE
VEZIRE DUSHI

## KERKESE

**KERKUESI** Artur Rustemi i biri i Hetemit dhe i Hedijes dtl. 1958 banues ne Fier administrator i shoqerise tregetare " F K T " SHPK

**OBJEKTI** Depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykates te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " F K T " shpk

Gjykates se shkalles se Pare

TIRANE

Me vendimin nr. 29o25 date 5.2.2003 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare " F K T " shpk

Me vendimin e ortakut te vetem te kesaj shoqerie eshte vendpsur pakesimi i objektit ne fushen e Veprimtari kinomatrografike per cfaqje publike filmash dhe distribucion(s perndarje) e tyre. Studio per prodhim videokasetash muzikore e filmash, prodhin disqesh muzikore si dhe tregetimin e tyre.

Studio fotografike.

Eshte vendpsur gjithashtu shtimi i objektit te veprimtarise se shoqerise ne fushen e Trasmetime heprmjet radios lokale.

Kerkojme depozitimin e ketij vendimi prane rregjistrit tregetar te Gjykates.

Kerkuesi

Artur Rustemi

29025/1

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.P.K."F K T"
F I E R

Fier me 20.10.2003

**K E R K E S E**

**KERKUES:** ARTUR RUSTEMI biri i Hetemit dhe i Hedijes, lindur me 1958 ne Fier dhe banues po aty.

**OBJEKTI:** DEPOZITIM NDRYSHEMESH.

**P E R P A R A**

GJYKATES SE SHKALES SE PARE TE RRETHIT

**T I R A N E**

Une kerkuesi jam ortaku i vetem i sh.p.k. "F K T ", me seli ne Fier.

Me vendimin Nr.29025 dt.05.02.2003 te gjykates se shkalles se pare Tirane jem regjistruar si person Juridik,duke u lejuar qe te ushtroje aktivitetin privat sipas vendimit te cituar me siper.

Une si ortak i vetem, me dt.20. 10.2003, vendosa te bej ndryshme ne statutin dhe aktin e themelimit te sh.p.k. dhe konkretisht ne nenet 5 dhe 17 te Statutit:

1. *Te shtoje ne objektin e veprimtarise se sh.p.k. edhe aktivitetin :Transmetim nepermjet radios Lokale :*

Ne keto kushte ndyshohen nenet 5 dhe 17 te Statutit te sh.p.k. dhe Akti i Themelimit ne pjesen takuese, sipas ketyre ndryshmeve.

Ne keto kushte nga gjykata e shkalles se pare te rrethit Tirane, pasi te shqyrtohen kerkesa dhe aktet bashkelidhur saj

**K e r k o j :**

*Depozitimin e ndryshimeve, sipas vendimit nr.1 dt.20.10.2003 te Oratkut te vetem Artur Rustemi.*

O R T A K U
A D M I N I S T R A T O R I
ARTUR RUSTEMI

30 01 2003

30 GEN. 2003

Fier,me 28.01.2003

# KERKESE

KERKUESI: ARTUR RUSTEMI,bir i Hetemit dhe Edijes,vitlindjes 1958,banues nelagjen "1 maj"te qytetit Fier,me cilesine e administratorit te shoqerise tregtare "F K T"shpk Fier.

OBJEKTI: Kerkohet regjistrimi si person juridik i shoqerise tregtare "F K T"shpk Fier.

BAZA LIGJORE: 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji 7667 date28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen te respektojne shoqerite tregtare".

IT

E

Shoqeria tregtare " F K T " shpk Fier eshte krijuar nepermjet akt themelimit date 22.01.2003 te ortakut te vetem Artur Rustemi,i cili njokohesisht eshte edhe administrator i saj.

Selia dhe qendra e shoqerise tregtare eshte ne lagjen "28 nentori" te qytetit Fier,kapitali themltar eshte 1000000(njeqindmije) leke,prone e ortakut te vetem,kohezgjatja eshte per 10 vjet.

Objekt i veprimtarise se kesaj shoqerie tregtare eshte:Veprimtari televizive lokale;veprimtari kinematografike per shfaqje publike filmash dhe distribucion(shperndarje) te tyre;studjo per prodhim videokasetash muzikoree filmash,prodhim disqesh muzikore si dhe tregtim te tyre;studjo fotografike.

Duke qenese plotesohen gjithe kerkesat ligjore dhe dokumentacioni eshte i rregullt kerkoj qe te regjistrohet person juridik ne regjistrin tregtar prane asaj gjykate,shoqeria tregtare "F K T"shpk Fier.

Bashkengjitur nje kopje e akt themelimit,nje kopje e statutit dhe vertetimi kapitalit themeltar.

06/2/2003

KERKUESI
Artur Rustemi
Artur Rustemi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT FIER
Nr...136........

Fier,me 28.01.2003

## VERTETIM

Ne Fier,sot me date 28.01.2002 para meje noteres u paraqit z.ARTUR HETEM RUSTEMI,vitlindjes 1958,banues ne l."1 maj"te qytetit Fier,me zotesi te plote per te vepruar,njohur me pasaporte personale.Ai deklaroi se kete kerkese e ka bere vete dhe nenshkruan me vullnet te lire te tij, ne pranine time,une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
VEZIRE DUSHI

REPUBIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT TIRANE
Nr...3/4.....regj.

Tirane,me..05/02/....2003

# VERTETIM

Vertetoj se zoti ARTUR HETEM RUSTEMI,banues ne Fier ka depozituar prane kesaj zyre noterie shumen prej 100.000(njeqindmije) leke,si kapital themeltar per krijimin e shoqerise tregtare "F K T" shpk Fier,ku ai eshte ortak i vetem dhe njekohesisht administrator i saj.

Leshohet me kerkesen e te interesuarit.

NOTERI

MINELLA MILO

# V E N D I M

Nr. 1 date 20.10.2003

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGETARE " F K T " SHPK

Une Artur Rustemi ortak i vetem dhe administrator i shoqerise tregetare " F K T " SHPK ne mbledhjen time te dates 20.10.2003 kam vendosur:

Pakesimin e objektit ne fushen e V.

Veprimtari kinomatografike per cfaqje publike filmash dhe distribucion(shperndarje te tyre.

Studio per prodhim videokasetash muzikore e filmash, prodhim disqesh muzikore si dhe tregetimin e tyre.

Studio fotografike.

Kam vendpsur gjithashtu edhe shtimin e objekti te veprimtarise ne fushen e

V~~eprimtari televizive~~e

Trasmetime neprrmjet radios lokale.

Duke mbetur objekti i veprimtarise se shoqerise ne fushen e :

Veprimtari televizive

Transmetime nepermjet radios lokale.

Mblefhja u mbyll me kete rend dite.

Ortaku i vetem i shoqerise
tregetare " F K T " shpk

Artur Rustem